



e Rahovecit

Komuna e Rahovecit mbështet 247 fermerë blegtorë

Këtë vit, Komuna e Rahovecit ka subvencionuar 247 fermerë blegtorë, me një vlerë të përgjithshme prej 57,700.00€.

Ky subvencionim synon të lehtësojë punën e tyre dhe të nxisë zhvillimin e blegtorisë, si një sektor i rëndësishëm për komunën tonë.

Po vazhdon përkrahja e bujqve me inpute bujqësore

Komuna e Rahovecit po i përkrah drejtpërdrejt bujqit, ku në fazën e dytë, po vazhdon shpërndarja e plehut artificial për 581 bujq përfitues, sipas kriterëve të përcaktuara nga DBPZhR-ja.

